



# DERË E HAPUR PËR TË GJITHË



## TA AVANCOJMË SHTETIN TONË

EMA (15), BESMIR (15), AGON (15), DION (14), RINA (14), DIONA (14), GURI (14), ELDA (15),  
ERRITA (14)



Përmes këtij vizatimi duam të tregojmë se në demokraci ka diversitet dhe të gjithë duhet ta pranojmë njëri-tjetrin siç jemi

**Më poshtë mund të kuptoni më shumë rreth demokracisë. Gjithashtu, mund të kuptoni si ndikon ajo në jetën e qytetarëve. Këtë do t'ua tregojmë përmes një historie të shkurtër të një mikut tonë**

Xhimi është një djalosh i sjellshëm dhe modest. Ai



Të drejtën e mjekimit e gëzojmë të gjithë, pa dallime

jeton në lagjen tonë, pak blloqe më tutje dhe është fjalëpak. Mirëpo, është shumë i dashur.

Një ditë duke biseduar me të, ai rastësisht na tregoi që nuk ndihej i kënaqur dhe nuk ndihej i sigurt për fenë që kishte. Prandaj, ai kishte vendosur ta ndërronte atë. Xhimi shumë i lumtur na tha se shoqëria dhe familja e tij e kishin mirëpritur këtë vendim dhe e përkrahin atë. Pasi Xhimi na tregoi historinë e tij, ne u habitëm sepse nuk e kemi ditur se një person është i lirë ta ndërrojë

fenë e tij. „Këtu, Xhimi theksoi, „meqë jetojmë në një shtet demokratik ne jemi të lirë dhe kemi të drejtë të zgjedhim fenë që duam. Jo vetëm fenë. Ne jemi të lirë edhe të shprehim mendimet tona.“ Më pas vazhduam bisedimin tonë rreth demokracisë.

Në këtë mënyrë, ne kuptuam më shumë rreth këtij sistemi. Kuptuam disa elemente të demokracisë të cilat janë: liria, paqja, solidariteti, barazia, toleranca, etj. Edhe pasi u ndamë nga Xhimi, ne vazhduam t'i tregonim njëri-tjetrit për jetën e lirë që duhet ta ketë çdo njeri.

Kjo bisedë na bëri të reflektojmë shumë. Na bëri të kuptojmë se në demokraci secili është i lirë të veprojë ashtu si ka dëshirë. Andaj, ne duhet ta pranojmë secilin qytetar pa bërë dallime. Këtë ua themi ne, gazetarët e demokracisë, të cilët shpresojnë që të gjithë të jemi sa më demokratik.




Autorët e artikullit



## BARAZIA NË TË DREJTË VOTE

ALBI (14), SHEMSEDIN (14), ELDA (15), ANDA (14), DITA (15), ELION (14), GERT (14), BARDH (15),  
LEONA (14)



**Rëndësia e zgjedhjeve në jetën e qytetarëve është e padiskutueshme. Falë tyre, gjithmonë janë bërë ndryshime të nevojshme dhe shumë pozitive. Nëse edhe ju të dashur lexues, ndonjëherë mendoni që të kandidoni për ndonjë pozitë, duhet ta dini që qytetarët duhet të jenë të lirë në zgjedhje e jo t'iu imponohet vota. Kështu duhet të funksionojnë qytetarët të cilët rriten në frymë demokratike**

Në vitin 2008 ne gëzuar të drejtën e pavarësisë, lirisë, tolerancës dhe paqes. Përpos të drejtave, ne gëzuar dhe të drejtën e vendimmarrjes, që do të thotë të drejtën e votës së lirë. Çdo qytetar gëzon të drejtën që të ketë një mendim të pavarur dhe ta shpreh atë lirshëm. Barazia është elementi bazik i demokracisë. Qytetarët në demokraci kanë të drejta, por duhet t'i mbajnë përgjegjësitë e tyre, të cilat janë të vendosura me ligj. Zgjedhjet e para pas shpalljes së Pavarësisë u mbajtën në vitin 2010. Ligji e përcakton që zgjedhjet mbahen çdo 4 vjet. Qytetarët marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve: në ato lokale dhe qendrore. Në zgjedhjet lokale zgjedhet asambleja dhe kryetari i komunës përkatëse. Kurse, në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët. Vota është e drejtë e pacenueshme dhe duhet të jetë ano-


nime dhe e lirë. Mos të harrojmë, se qytetarët të cilët marrin pjesë në procesin zgjedhor janë mbi moshën 18 vjeçare. Qytetarët mund të votojnë disa kandidatë dhe në fund me vota anonime zgjedhen udhëheqësit e shtetit. Nëse qytetari është me nevoja të veçanta, atëherë mund të asistohet nga ndonjë i afërm i tyre. Pra, demokracia është e vlefshme, aq sa liria që e gëzojmë. Edhe ne si nxënës bëjmë disa zgjedhje pothuajse të njëjta si këto që i kemi cekur: secila klasë zgjedh një kryetar të klasës përkatëse. Të gjithë kryetarët së bashku formojnë këshillin e nxënësve. Ata përfaqësues së bashku zgjedhin kryetarin e këshillit. Pra, edhe këto zgjedhje janë vullnet i lirë i nxënësve, ashtu siç edhe qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e vet. Vota është ajo që bën ndryshim, shfrytëzojeni atë.




Vajzat dhe gratë duke kërkuar të drejtat e tyre



Bashkimi bën fuqinë



**Të kesh lirinë të flasësh atë që mendon, të kesh lirinë të zgjedhësh atë që dëshiron, të kesh lirinë që të vizitosh vendet që i pëlqen, të gjithë i bën të lumtur. Liria është një nga elementet kryesore në demokraci**



**Duke pranuar njëri-tjetrin dhe duke qenë të bashkuar mund të shkojmë përpara. Në demokraci çdo fëmijë dhe çdo qytetar e gëzon të drejtën e shkollimit, të drejtën e lojës, të drejtën e familjes, të drejtën e strehimit, etj**



**Ne, nxënësit e klasës së IX-të nga shkolla fillore „Fehmi Agani“ nga Gjakova, patëm mundësinë të jemi në rolin e gazetarëve të Kuvendit. Gjatë punës sonë, ne diskutuam për demokracinë dhe rolin që e kemi ne në demokraci**



# KUVENDI, INSTITUCIONI MË I LARTË LEGJISLATIV

ERJON (14), DONJET (14), JONA (14), DURIM (15), EMA (14), OLTİ (14), ELDA (14), MENTOR (14),  
VIGAN (14)



**Kuvendi është institucioni më demokratik i vendit. Vendimet të cilat merren aty nga deputetët, të cilët janë përfaqësuesit e popullit, ndikojnë në jetën tonë si qytetarë. Lexojeni këtë artikull, sepse pikërisht këtu është shpjeguar se si ndikon Kuvendi në jetën tonë**

Ishte shtator i vitit 2008. Natë me shi, dhe një qytetar ishte duke vozitur makinën e tij. Era i lëvizte pemët anash rrugës. Nuk shihej lëvizje njeriu. Shoferi nuk i shihte aq mirë shenjat e trafikut, dhe filloi ta rriste shpejtësinë edhe pse po kalonte në një vendbanim ku mund të dilte ndonjë qytetar. Papritur doli një këmbësor konfuz, i cili dëshironte të kalonte në anën tjetër të rrugës. Aty ndodhi aksidenti mes shoferit që i injoroi shenjat e trafikut dhe këmbësorit i cili për dallim nga shoferi, i takonte një etnie tjetër. Këtij këmbësori iu respektuan të drejtat sikur secilit qytetar tjetër. Nuk kishte dallime në vënien e drejtësisë. Për shkak të mosrespektimit të rregullave të komunikacionit dhe meqë shkaktoi aksidentin, ngasësi i veturës u dënua. Kurse, këmbësori u shërua në spitalin më të afërt.

Në vendet demokratike, të drejtat e barabarta pa dallim gjinie, moshe, feje, race, etniteti, etj., janë të garantuara me ligj. Kuvendi si institucion legjislativ, merr vendime për këto ligje që janë në dobi të të gjithë popullit.

Të jesh i barabartë me të tjerët është tejet e rëndësishme, sepse qytetarët sa janë të ngjashëm, aq janë të ndryshëm nga njëri-tjetri.

Si shembull mund të merret edhe garantimi i vendeve për komunitetet jo shumicë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Prej 120 vendeve, 100 janë për deputetët me kombësi shqiptare, kurse 20 të tjera janë për deputetët e komuniteteve jo shumicë, siç janë: serbë, romë, ashkali, egjiptas, boshnjakë, turq dhe goranë. Në fund kemi një mesazh për ju të dashur lexues: të punojmë sa më shumë dhe të qëndrojmë të bashkuar. Kështu, mund të arrijmë që të kemi një të ardhme të ndriçuar.



Ne jemi gazetarët e këtij artikulli



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Gjakovë